

AMBASADORI FRANCEZ BËN THIRRJE TË RESPEKTOHET GJYKATA KUSHTETUTUESE



Ambasadori i Francës në Prishtinë, Olivier Guerot, ka deklaruar se Gjykata Kushtetuese e Kosovës gëzon respekt të madh ndërkombëtar,

duke theksuar se ajo është anëtare e plotë e Asociacionit Evropian të Gjykatave Kushtetuese dhe rrjetit frankofon të gjykatave kushtetuese.

Prandaj, sipas tij, aktorët politikë në Kosovë duhet të tregojnë të njëjtin nivel respekti dhe ta ruajnë pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese

OSMANI: KOSOVA, VENDI MË PRO-AMERIKAN NË BOTË, TRUMPI NA KA NDIHMUAR PËR TA RUAJTUR PAQEN

F. 5



DHUNA NË SHKOLLA: KUR FRIKA ZË VENDIN E MËSIMIT

F. 7



RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht -Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



OUSMANE DEMBELE SHPALLET FITUES I "TOPIT TË ARTË"

F. 10

SPORT

ODA EKONOMIKE AMERIKANE DISKUTON ME GUVERNATORIN E BQK-SË PËR STABILITETIN FINANCIAR DHE INTEGRIMIN E KOSOVËS NË SEPA

F. 8

AUDITORJA E PËRGJITHSHME REKOMANDON KOORDINIM NDËRINSTITUCIONAL PËR RUAJTJEN E HAPËSIRAVE PYJORE TË KOSOVËS

F. 8

EKONOMI



NATO PARALAJMËRON RUSINË "T'I NDALË" SHKELJET E HAPËSIRAVE AJRORE

F. 2

KURTI REFUZON TË FLASË PËR FORMIMIN E QEVERISË

F. 7

AIP KËRKON NGA PARTITË POLITIKE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË QYTETARËVE GJATË FUSHATËS

F. 5

OPINION



OPINION

NATO PARALAJMËRON RUSINË “T’I NDALË” SHKELJET E HAPËSIRAVE AJRORE

BRUKSEL, 23 SHTATOR - NATO paralajmëroi Rusinë ta ndalë sjelljen “përshkallëzuese” të shkeljeve të hapësirave ajrore në krahun e saj lindor, pasi aleanca mbajti bisedime urgjente pas inkursionit të javës së kaluar në Estoni. “Rusia mban përgjegjësinë e plotë të këtyre veprimeve, që përshkallëzojnë situatën, që rrezikojnë të ketë keqlllogaritje dhe vënë në rrezik jetën e njerëzve. Këto veprime duhet të ndalen”, tha aleanca ushtarake prej 32 anëtarësh përmes një njoftimi. “Rusia nuk duhet të dyshojë: NATO dhe aleatët, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, do t’i përdorin të gjitha mjetet e nevojshme ushtarake dhe joushtarake për ta mbrojtur veten dhe për t’i penguar të gjitha kërcënimet nga të gjitha drejtimet”. Në njoftim u shtua se NATO “do

të vazhdojë të përgjigjet në mënyrën, kohën që zgjedh” dhe se angazhimi i aleancës për paktin e saj të mbrojtjes kolektive mbetet “i pathyeshëm”. Estonia thirri konsultimet emergjente sipas Nenit 4 të traktatit themeltar të NATO-s pasi avionë luftarakë rusë shkelën hapësirën e saj ajrore për 12 minuta të premten e kaluar. Ky incident - gjatë të cilit NATO-ja ngriti në ajër avionë - ndodhi një javë pasi aleanca rrëzoi dronë rusë mbi Poloni, duke e detyruar Varshavën të thërrasë konsultime të ngjashme. Në përgjigje të inkursionit rus me dronë në Poloni, NATO-ja njoftoi se po forconte mbrojtjen e saj në lindje për të ndihmuar në zmbarsjen e kërcënimit nga Rusia. Përveç Polonisë, në krahun



lindor të NATO-s janë edhe Rumania, Lituania, Letonia dhe Finlanda që, po ashtu, kanë raportuar së voni shkelje të hapësirave të tyre ajrore. Rritja e tensioneve ka nxitur

frikë se lufta e Rusisë në Ukrainë mund të përhapet në mbarë kufirin e NATO-s. Shtetet e NATO-s u zotuan se “këto veprime dhe veprime të tjera të papërgjegjshme të

Rusisë nuk do ta zmbarsin përkushtimin e aleatëve për mbështetjen për Ukrainën”. Sipas Nenit 4 të NATO-s, çdo anëtar mund të thërrasë diskutime urgjente kur ndien se “integriteti i tij territorial, pavarësia politike apo siguria” janë në rrezik. Bisedimet e së martës shënojnë herën e katërt që kur është aktivizuar Neni 4 që kur Rusia nisi pushtimin e plotë të Ukrainës më 2022 dhe, po ashtu, shënojnë herën e nëntë që kur u themelua aleanca 79 vjet më parë. Ndërkaq, siguria kolektive e NATO-s bazohet në parimin e Nenit 5: nëse një anëtar sulmohet, e gjitha aleanca i del në mbrojtje. Ky nen është aktivizuar vetëm një herë në historinë e NATO-s pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 në Shtetet e Bashkuara.

SUEDIA BËN THIRRJE PËR ‘GATISHMËRI LUFTE’ NË EVROPË

STOKHOLM, 23 SHTATOR - Ministri suedez i Mbrojtjes, Pal Jonson, të martën bëri thirrje që Evropa t’i rrisë përgatitjet për një konflikt të armatosur për shkak të kërcënimit që paraqet Rusia. “Ne duhet të adoptojmë një mentalitet të ri evropian, të kalojmë nga një mentalitet i kohës së paqes në një gatishmëri lufte”, tha Jonson në Berlin përpara një takimi me homologun e tij gjerman, Boris Pistorius, raporton DPA. Rusia po armatoset masivisht dhe po ndërton një ushtri “më vdekjeprurëse”, duke bërë përparime të mëdha në armët me rreze të gjatë dhe në luftën elektronike, tha Jonson në një aktivitet në Fondacionin Konrad Adenauer. Ai



paralajmëroi se vendet e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) duhet të koordinohen më ngushtë në mbrojtje. “Flasim për një larmi brenda aleancës sa i përket investimeve në mbrojtje”, tha Jonsoni. “Kjo nuk është gjë e mirë. Nuk dua të shoh fragmentim në investimet për mbrojtjen”. Pas neutralitetit gjatë Luftës së Ftohtë, Suedia iu bashkua NATO-s vitin e kaluar si përgjigje ndaj pushtimit rus të Ukrainës. “Ne e shohim Ukrainën si mburojë - ose si shpatë, nëse doni - kundër zgjerimit ushtarak rus”, tha ai. “Por, tani, po shohim gjithashtu se barra e mbështetjes financiare për

Ukrainën po mbahet nga gjithnjë e më pak aleatë brenda NATO-s”. Jonson kërkoi, gjithashtu, një bashkëpunim më të fortë dypalësh në fushën e mbrojtjes me Gjermaninë, duke argumentuar se të dy qeveritë duhet ta promovojnë standardizimin dhe kontratat afatgjatë. Sipas tij, Berlini dhe Stokholmi po ndjekin një rrugë të ngjashme për strategjinë e mbrojtjes. Të dy vendet po investojnë shuma rekorde në mbrojtje, pas një periudhe të gjatë të investimeve të vogla, ndërsa përballen me të njëjtat sfida nga lufta në Ukrainë dhe kërcënimi rus në rajonin e Detit Baltik.

RAMA: DIALOGU KOSOVË - SERBI KA DËSHTUAR, KOSOVA RREZIKON IZOLIM NËSE NUK PRANON KËRKESAT E BE-së

TIRANË, 23 SHTATOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka folur nga Vjena, ku po merr pjesë në konferencën “Shqipëria, horizonti i ri”, për rrugëtimin e vendit drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke u shprehur se Shqipëria është në rrugën e duhur dhe se në vitet e fundit ka shënuar ecuri pozitive krahasuar me fqinjët në rajon. Rama bëri një krahasim të drejtpërdrejtë me Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, duke thënë se Shqipëria tashmë i ka parakaluar ato në këtë proces

dhe se Kosova e Serbia duhet të gjejnë një zgjidhje. “Më parë ishte Maqedonia, tani nuk është kurrkund në hartë. Është dhe Serbia, që nuk është gjëkundi. Ndërkohë, Shqipëria konsiderohej si ‘kush e di’. Jemi më përpara. Është shumë politike, hipokrite, marrëzi. Shpresoj që Serbia të drejtohet në mënyrën e duhur, por edhe Bosnjë-Hercegovina. Ne duhet t’i zgjidhim gjërat tona. Ndërkohë, Kosova dhe Serbia duhet të gjejnë zgjidhje, pasi Beogradi do ta mbyllë më shumë veten nëse nuk zgjidh gjë”, tha Rama.

Kryeministri foli edhe për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Më vjen keq që nuk ka përparim. Serbia duhet ta bëjë pjesën e vet, t’i bëjë detyrat e veta dhe duhet t’i japë BE-së të gjithë fletoren me detyrat e bëra të shtëpisë dhe të ecë përpara. Kjo ka të bëjë me pranimin e asaj që kërkon BE. Ky dialog i ndërmjetësuar nga BE është dështim, sepse formati nuk është i duhuri. Kosova thjesht duhet ta bëjë këtë gjë. Në të kundërt do ta izolojë veten më shumë dhe do jetë më keq”, theksoi Rama.



Osmani dhe Ruge flasin për anëtarësimin e Kosovës në NATO

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka njoftuar se ka zhvilluar takim me ndihmës sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, ambasadorin Boris Ruge. Ajo tha se ka potencuar angazhimin e Kosovës për anëtarësim në Aleancën Veriatlantike. “Gjatë takimit ritheksa mirënjohjen e popullit të Kosovës për kontributin e vazhdueshëm të NATO-s në vendin tonë si dhe

përkushtimin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në Aleancën Veriatlantike”, u shpreh Osmani. Aktualisht Osmani po qëndron për një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ku gjatë këtyre ditëve është takuar kryesisht me përfaqësues të diasporës. Marrëdhëniet në mes të Prishtinës dhe Uashingtonit janë dobësuar ndjeshëm

kohët e fundit, kryesisht për shkak të bindjes së administratës amerikane se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, nuk ka treguar gatishmëri për bashkëpunim, pavarësisht prej thirrjeve, rekomandimeve dhe përkushtimit ndaj Kosovës. Për këtë arsye, dy javë më parë ambasada e ShBA-së në Prishtinë njoftoi se dialogu strategjik me Kosovën është pezulluar.



KOSOVA, E TRETA NË BOTË, E PARA NË EVROPË PËR SIGURI, SIPAS RAPORTIT GALLUP

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Raporti më i ri ndërkombëtar Gallup Global Safety Report 2025, i publikuar në fillim të muajit shtator, ka renditur Kosovën ndër vendet më të sigurta në botë, duke e pozicionuar të tretën në nivel global dhe të parën në Evropë për ndjenjën e sigurisë së qytetarëve dhe besimin ndaj institucioneve të zbatimit të ligjit. Sipas raportit, Kosova ka arritur rezultat 94 pikë nga 100 në Indeksin e Ligjit dhe Rendit, duke u renditur menjëherë pas Takhikistanit (97 pikë) dhe Singaporit (95 pikë) si tre

vendet më të sigurta në botë. Ky rezultat e bën Kosovën vendin më të sigurt në Evropë, duke lënë pas shtete të zhvilluara si Islanda, Norvegjia, Austria dhe Zvicra. Po ashtu, raporti thekson se 89 % e qytetarëve të Kosovës ndihen të sigurt duke ecur vetëm natën në zonën ku jetojnë, përqindje që e vendos Kosovën në mesin e vendeve me nivelin më të lartë të perceptimit të sigurisë në botë dhe në Evropë. Këto rezultate janë të lidhura ngushtë edhe me përkrahjen e vazhdueshme që Policia e Kosovës gëzon nga institucionet vendore dhe



partnerët strategjikë ndërkombëtarë si dhe falë

bashkëpunimit të ngushtë me institucionet e tjera të

sigurisë të cilat së bashku krijojnë një sistem gjithëpërfshirës për garantimin e rendit dhe sigurisë në vend. Ky vlerësim ndërkombëtar është një dëshmi e qartë e përkushtimit të Policisë së Kosovës në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, forcimin e bashkëpunimit e partneritetit me komunitetin dhe rritjen e besimit të qytetarëve në Policinë e Kosovës. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për mbrojtjen e jetës dhe pronës, ofrimin e sigurisë dhe shërbim sa më profesional, efektiv dhe llogaridhënës për të gjithë qytetarët pa dallim.

NË KLINIKËN OBSTETRIKE DHE GJINEKOLOGJIKE KRYHEN DY OPERACIONE TË RRALLA



PRISHTINË, 23 SHTATOR - Në Klinikën Obstetrike dhe Gjinekologjike (KOGj), të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës, për herë të parë janë kryer me sukses dy operacione të rralla dhe shumë të rëndësishme për pacientet. Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës ka njoftuar se ky sukses është rezultat i bashkëpunimit profesional ndërmjet stafit të klinikës dhe dr. Alban Nezirit, gjinekolog, i cili jeton dhe punon në Zvicër, i cili me përvojën dhe ekspertizën e

tij dha një kontribut të jashtëzakonshëm për realizimin e këtyre ndërhyrjeve për herë të parë në vendin tonë. Po ashtu, thuhet se kontribut të çmuar ka dhënë ekipi i gjinekologëve nga klinika e, po ashtu, anesteziologëve dhe stafit nga Klinika e Anesteziologjisë. “Operacionet janë realizuar te dy paciente me anomalie kongjenitale të organeve gjinitale, ku gjatë zhvillimit embrional nuk janë zhvilluar plotësisht disa pjesë të tyre (mitra dhe vagina). Ky është një

hap i madh drejt përmirësimit të cilësisë së jetës së këtyre pacienteve dhe hap mundësinë që në faza të ardhshme, në qendra të specializuara evropiane, të kryhet edhe transplantimi i mitrës. QKUK, falënderon përzemërsisht Dr. Alban Nezirin për kontributin e tij të çmuar në këtë arritje të rëndësishme, si dhe të gjithë stafin e Klinikës së Obstetrikës dhe Gjinekologjisë dhe Klinikës së Anesteziologjisë për angazhimin, përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar”, ka njoftuar ShSKUK-ja.

Rregullatori i barnave i BE-së: Paracetamoli është i sigurt për t’u përdorur gjatë shtatzënisë

BRUKSEL, 23 SHTATOR - Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) tha të martën se nuk ka prova të reja që do të kërkonin ndryshime në rekomandimet aktuale të rajonit për përdorimin e paracetamolit, i njohur si Tylenol në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjatë shtatzënisë. Presidenti amerikan Donald

Trump të hënën e lidhi autizmin me përdorimin e vaksinave të fëmijërisë dhe marrjen e ilaçit të njohur kundër dhimbjeve, Tylenol, nga gratë gjatë shtatzënisë. Kështu, ai e ngriti në qendër të politikës shëndetësore të ShBA-së një pretendim që nuk mbështetet nga prova shkencore. “Provat e

disponueshme nuk kanë gjetur asnjë lidhje mes përdorimit të paracetamolit gjatë shtatzënisë dhe autizmit”, tha EMA në një deklaratë për Reuters. Agjencia shtoi se paracetamoli mund të përdoret gjatë shtatzënisë kur është i nevojshëm, por gjithmonë në dozën dhe shpeshtësinë më të ulët efektive.



OSMANI: KOSOVA, VENDI MË PRO-AMERIKAN NË BOTË, TRUMPI NA KA NDIHMUAR PËR TA RUAJTUR PAQEN

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se administrata amerikane ka bërë punë të mirë për parandalimin e përshkallëzimit të situatës në mes të Kosovës dhe Serbisë, por theksoi se Beogradi paraqet një kërcënim të vazhdueshëm për Prishtinën.

Në një intervistë për “Fox News”, Osmani u pyet nëse Kosova dhe Serbia ishin buzë një konflikti në qershor. Osmani tha se fqinjët verior të Kosovës i “pëlqen të shkaktojë probleme herë pas here”. Ajo tha se Serbia në të kaluarën, kur udhëhiqej nga Slllobodan Millosheviqi, ishte përgjegjëse për një sërë konfliktesh, por edhe tani, sipas saj, në udhëheqjen e Serbisë, ka ende njerëz “të cilët pëlqejnë të kapen pas së kaluarës dhe të na kthejnë të gjithëve në të kaluarën, teksa ne dëshirojmë të shohim nga e ardhmja”. “Presidenti [amerikan, Donald] Trump na ka ndihmuar shumë në mbështetje të paqes, për ta ruajtur paqen dhe për të shpëtuar jetë”, tha Osmani.

Presidentja e Kosovës tha se me Serbinë në vitet e fundit ka pasur një sërë tensionesh, përfshirë edhe sulmin në Banjskë më 2023, kur një grup i serbëve të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës dhe vranë një rreshtar.

Kosova fajëson Serbinë për këtë rast, por Beogradi mohon se ka gisht në të. “Ne arritëm ta zmbrapsim atë me mbështetjen e aleatëve tanë të NATO-s. Megjithatë, ekziston një

kërcënim i vazhdueshëm që vjen nga Serbia. Në majin e kaluar, padyshim, pati një tjetër përprjekje tensioni, nëse mund ta quaj kështu, dhe kjo administratë ka bërë një punë të mrekullueshme për të parandaluar që këto të përshkallëzohen”, tha Osmani.

Osmani tha se mbështet politikën e Trumpit “paqe përmes forcës” pasi, sipas saj, ky është mesazhi i vetëm që autokratët e kuptojnë.

Muajt e fundit presidenti Trump disa herë ka deklaruar se ka parandaluar një përshkallëzim në mes të Kosovës dhe Serbisë. Osmani ka konfirmuar deklaratat e udhëheqësit amerikan, duke thënë se në maj kishte pasur informacione për veprimet e Serbisë në kufi me Kosovën. “Më konkretisht në fund të muajit maj kemi marrë informacione specifike lidhur me veprimet e Serbisë në kufi me Kosovën. Menjëherë pas marrjes së këtyre informacioneve kam pasur takime me institucionet e sigurisë të cilat më raportojnë si presidente. Jemi siguruar që çdo institucion në Kosovë ka mobilizim të duhur për mbrojtje të vendit”, ka thënë ajo në korrik të këtij viti.

Serbia ka mohuar këto pretendime të Osmanit.

Osmani në ShBA po merr pjesë në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ku po zhvillon takime të ndryshme. Trumpi pritet t’i drejtohet OKB-së më vonë gjatë 23 shtatorit.



Çfarë tha Trumpi?



Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, shkroi në rrjetin “Social Truth” më 15 qershor se gjatë mandatit të tij të parë presidencial, Kosova dhe Serbia po “shkonin drejt një konflikti serioz” dhe se lufta ishte në prag të shpërthimit, por se ai e ndaloi atë.

Më 25 qershor Trumpi tha se “gjatë

javëve të fundit, u morëm me Indinë dhe Pakistanin, Kosovën, Serbinë. Mendoj se të premten do të kemi vizita nga Kongo dhe Ruanda”. Ai e bëri këtë deklaratë në një konferencë për medie në samitin e NATO-s në Hagë.

Më 27 qershor, duke folur në Zyrën Ovale për përprjekjet e administratës së tij për të zgjidhur konflikte të mundshme, Trumpi tha se: “... në Serbi dhe Kosovë zgjidhëm një katastrofë të mundshme”.

Një ditë më vonë, më 28 qershor, Trumpi tha se “për vetëm disa muaj, kemi arritur paqe midis Indisë dhe Pakistanit, Izraelit dhe Iranit, si dhe midis Republikës Demokratike të Kongos dhe Ruandës - dhe disa të tjerë gjithashtu”. “Serbia, e dini, po përgatitej të shkonte në luftë me një grup. Nuk dua ta përmend,

sepse nuk ndodhi - ne arritëm ta ndalnim. Por, kam një mik në Serbi që më tha: ‘Do të hyjmë sërish në luftë’. Dhe nuk dua të them që është Kosova, por është Kosova. Do të niste një luftë e madhe, por ne e ndalëm. E ndalëm për shkak të tregtisë. Ata duan të tregtojnë me Shtetet e Bashkuara. U thashë: ne nuk tregtojmë me ata që hyjnë në luftë”.

Më vonë, më 9 korrik, ai përsëriti: “Kam arritur të zgjidh shumë situata, si ajo me Indinë dhe Pakistanin, Kosovën dhe Serbinë. Thashë: a do të luftoni? Ne nuk do të bëjmë tregti. Dhe, duket se kjo ka qenë mjaft e suksesshme”.

Trumpi e përmendi rastin e Kosovës dhe Serbisë edhe gjatë një takimi me shefin e NATO-s, Mark Rutte, më 14 korrik në Shtëpinë e Bardhë.

S’SHOH “AS RESPEKT, AS DASHURI” NGA KURTI PËR SHBA-në, THOTË MOORE

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Jonathan Moore, ish-diplomat amerikan, ka shprehur drojë për qëndrimin e kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, ndaj Shteteve të Bashkuara. Ai theksoi për “A2CNN” se nuk sheh “as respekt, as dashuri” nga Kurti për popullin amerikan, duke vënë në dukje rëndësinë historike të mbështetjes së ShBA-së për Kosovën. “Është e çuditshme. Ja ku jemi në Prishtinë dhe nuk shoh apo dëgjoj nga Kurti ndonjë respekt apo dashuri për Shtetet e Bashkuara, për popullin amerikan. Njerëzit në Kosovë e dinë rolin historik, por kjo nuk reflektohet në qëndrimet apo qasjen e Kurtit”, tha ai.

Moore komentoi edhe situatën

politike në Kosovë, duke theksuar se vendi është i vetmi në Evropë që nuk ka ulësë Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ai ironizoi duke vlerësuar se autoritetet e Kosovës i kushtojnë më shumë vëmendje marrjes së njohjes nga Ishujt Solomon apo Tuvalu sesa sfidave të tjera në nivel rajonal dhe global.

Raportet dypalëshe në mes të Prishtinës dhe Uashingtonit janë dobësuar ndjeshëm, kryesisht për shkak të bindjes së administratës amerikane se Kurti nuk ka treguar gatishmëri për bashkëpunim gjatë mandatit të tij në krye të qeverisë, pavarësisht prej thirrjeve, rekomandimeve dhe përkushtimit amerikan ndaj Kosovës.



AMBASADORI FRANCEZ BËN THIRRJE TË RESPEKTOHET GJYKATA KUSHTETUTA

Ambasadori i Francës në Prishtinë, Olivier Guerot, ka deklaruar se Gjykata Kushtetuese e Kosovës gëzon respekt të madh ndërkombëtar, duke theksuar se ajo është anëtare e plotë e Asociacionit Evropian të Gjykatave Kushtetuese dhe rrjetit frankofon të gjykatave kushtetuese. Prandaj, sipas tij, aktorët politikë në Kosovë duhet të tregojnë të njëjtin nivel respekti dhe ta ruajnë pavarësinë e Gjykatës Kushtetuese



PRISHTINË, 23 SHTATOR - Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ka theksuar rëndësinë e respektimit të pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese dhe ka shprehur shqetësimin e tij për vonesat në formimin e institucioneve funksionale në vend, duke i cilësuar ato si një fatkeqësi që po pengon zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Ambasadori i Francës në Kosovë ka pohuar se Gjykata Kushtetuese është një nga shtyllat e Republikës së Kosovës dhe ka fituar respekt të madh në arenën ndërkombëtare, duke u pranuar si anëtare e plotë në Shoqatën Evropiane të Gjykatave Kushtetuese dhe në Shoqatën e Gjykatave Kushtetuese frankofone. Guerot u bëri thirrje institucioneve vendore që ta ruajnë dhe ta respektojnë pavarësinë e saj pasi, sipas tij, kjo është thelbësore për funksionimin demokratik të

shtetit. “Do t’i ftoja institucionet që ta vazhdojnë ta respektojnë pavarësinë e gjykatës. Gjykata është një nga shtyllat e Republikës së Kosovës dhe për këtë kanë mbështetjen tonë të plotë”, ka thënë ai pas ngjarjes organizuar në Qendrën Mediale në Çagllavicë me temën “dezinformimi dhe lajmet e rreme në fushatë zgjedhore”. Duke folur për situatën aktuale politike, Guerot ka theksuar se mungesa e institucioneve të reja ka krijuar pengesa serioze për realizimin e projekteve ndërkombëtare, përfshirë ato të Agjencisë Franceze për Zhvillim, që kanë për synim mbështetjen e Kosovës në tranzicionin energjetik dhe përgatitjen për Lojërat Mesdhetare. “Mendoj se është fatkeqësi që jemi në këtë situatë. Kosova nuk është i vetmi vend ku ekziston një qeveri në detyrë. Në vendin tim aktualisht kemi një kryeministër, por jo një qeveri të re

të emëruar plotësisht, dhe ka shumë vende në Evropë në një situatë të ngjashme. Nuk është një situatë e mirë për asnjë vend dhe as për Kosovën, por tani jemi pak të bllokuar, sigurisht, sepse Kushtetuta e Kosovës thotë se çdo marrëveshje ndërkombëtare me implikime financiare duhet të ratifikohet nga Kuvendi, dhe ne nuk kemi një Kuvend që mund të funksionojë. Pra, të gjitha përpjekjet tona, jo vetëm të Francës, por duke folur për përpjekjet franceze, janë ngadalësuar nga kjo”, ka deklaruar ai.

Ambasadori Guerot ka theksuar se, pavarësisht prej bashkëpunimit teknik me qeverinë në detyrë, mungesa e një Kuvendi funksional ka bllokuar procedurat e ratifikimit për marrëveshjet me implikime financiare, ashtu siç kërkohet nga Kushtetuta. Në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi, ambasadori francez ka thënë se kjo është mënyra e vetme për të arritur përparim dhe ka vlerësuar udhëheqjen e këtij procesi nga Bashkimi Evropian, duke shtuar se ata që e quajnë dialogun të “vdekur”, në fakt po

promovojnë mungesën e përparimit. Ai rikujtoi se BE-ja, së bashku me shtetet anëtare si Franca, mbetet platforma më e rëndësishme për adresimin e çështjeve ndërmjet palëve dhe se angazhimi diplomatik është i domosdoshëm për të garantuar stabilitet dhe integritim. Sipas tij, marrëdhëniet me qeverinë aktuale ekzistojnë në nivel pune, por që kërkojnë një partner institucional të plotë për t’i avancuar më tej projektet dypalëshe dhe për ta forcuar bashkëpunimin ndërmjet Francës dhe Kosovës.

AIP KËRKON NGA PARTITË POLITIKE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË QYTETARËVE GJATË FUSHATËS

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Në përmbushje të detyrimeve ligjore, për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe sigurimin e integritetit të procesit zgjedhor, Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) kërkon nga partitë politike mbrojtjen e të dhënave personale gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale që do të mbahen më datë 12 tetor 2025. Sipas një njoftimi për medie, bëhet me dije se për ta siguruar mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve nga partitë politike dhe subjektet e përfshira në procesin e fushatës elektorale,



Agjencia kërkon zbatimin e detyrimeve ligjore dhe të ndërmarrjen e veprimeve në këtë drejtim. “Të sigurojnë çdo përpunim të të dhënave personale të kryhet mbi bazën ligjore të përpunimit, si: pëlqimi i

qytetarëve, interesi legjitim i subjektit politik apo arsye të tjera të përcaktuara me ligj, të mos përdoren të dhënat kontaktuese të qytetarëve të mbledhura gjatë ushtrimit të funksioneve publike apo në forma të tjera për qëllime

të marketingut politik. Të mos ekspozohen të dhënat personale gjatë komunikimit nëpërmjet postës elektronike (e-mail, mesazhet (SMS) dhe thirrjet telefonike, pa pëlqim paraprak). Të respektohen të drejtat e qytetarëve për të kundërshtuar në çdo kohë përdorimin e të dhënave të tyre për marketing të drejtpërdrejtë dhe ta ndërpresin menjëherë komunikimin pas paraqitjes së kundërshtimit. Ta shmangin çdo formë të profilizimit apo përpunimit masiv të të dhënave të ndjeshme përveç rasteve kur ekziston bazë e qartë ligjore dhe janë ndërmarrë masa mbrojtëse përkatëse, përfshirë vlerësimin paraprak të ndikimit mbi të dhënat personale kur është e nevojshme. Të

sigurojnë transparencë të plotë ndaj qytetarëve për mënyrën e përpunimit të të dhënave, duke publikuar politika të qarta të privatësisë në mënyrë të thjeshtë dhe të qasshme”, thuhet në njoftimin e AIP-së. Ndërkaq, siç thuhet në njoftim, për ta siguruar mbrojtjen e procesit zgjedhor në harmoni me detyrimet ligjore, Agjencia ofron bashkëpunim me subjektet politike për ta siguruar respektimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe u bënë thirrje partive politike që gjatë realizimit të aktiviteteve të fushatës zgjedhore, informatat e qytetarëve ruhen në përputhje me kërkesat ligjore.

Kosova në fokus, Elisa Spiropali vizitë në “International Crisis Group”

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e Shqipërisë, Elisa Spiropali, ka zhvilluar të martën një takim me presidenten e International Crisis Group, Comfort Ero, gjatë një vizite në selinë e kësaj organizate prestigjioze në Nju-Jork. Diskutimi u fokusua te çështjet e sigurisë rajonale,

me theks të veçantë te Kosova dhe rëndësia e garantimit të sigurisë së saj përmes integritetit euroatlantik. Spiropali vlerësoi rolin e ICG-së në analizën dhe parandalimin e krizave globale. Kryediplomatja mori pjesë në një tryezë të nivelit të lartë mbi promovimin dhe

mbrojtjen e të drejtave të njeriut, organizuar në kuadër të Reformës UN80. Në fjalën e saj, Spiropali theksoi se “të drejtat e njeriut nuk janë aksesore për paqen dhe zhvillimin, ato janë pjesa më thelbësore e tyre”. Ajo nënvizoi se Shqipëria është e gatshme të bashkëpunojë me partnerët ndërkombëtarë për ta



vendosur respektimin e të drejtave të njeriut në qendër

të Reformës UN80, “me qëllim rivitalizimin e premtimit për një botë më të drejtë, më të paqte dhe më të qëndrueshme”. Ministria Spiropali foli edhe për rëndësinë e institucioneve të qëndrueshme dhe fuqizimit të grave e të rinisë, duke i cilësuar si faktorë kyçë për përparim afatgjatë.

Rama: Kosova ndër vendet e para që integron IA-në në shkolla

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryetari aktual i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se gjatë këtij viti çdo shkollë fillore në kryeqytet do të përfitojë nga një orë mësimi mbi Inteligjencën Artificiale (IA) në kuadër të partneritetit me Shkollën Digjitale - institucion privat për trajnimin dhe edukimin e fëmijëve dhe adoleshentëve në teknologji dhe programim. Pas njohjes me konceptet bazë, sipas kryetarit të kryeqytetit,

nxënësit dhe mësimdhënësit do të marrin pjesë në trajnimet praktike “Ndërto me AI”, duke mësuar ta kthejnë dijen e fituar në projekte konkrete dhe të zbatueshme në jetën reale. “Ky hap e rendit Kosovën ndër vendet e para në botë që e futin IA-në në sistemin formal të shkollimit. Prishtina, përtej metodave të vjetruara të arsimit!”, ka shkruar në “Facebook” kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK),

i cili kërkon mandatin e tij të dytë. Në Kosovë ka nisur zyrtarisht fushata zgjedhore për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. E cikli i ri zgjedhor për kryetarë të komunave dhe kuvende komunale vjen në një kontekst të rënduar politik në Kosovë, ku edhe pas shtatë muajsh nga përfundimi i zgjedhjeve parlamentare, vendi nuk ka arritur t’i formojë institucionet e reja qendrore.



HADËRGJONAJ I KUNDËRPËRGJIGJET LLADROVCIT: KUR PENGOSHEJ EKZISTIMI I PDK-SË NË DEÇAN, KU ISHE TI RAMIZ?

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryetari aktual i Drenasit dhe kandidati edhe për një mandat të ri, Ramiz Lladrovci, në Debat Plus në RTV Dukagjini, duke komentuar vendimin e votimit të Kryesisë së PDK-së për mosvotimin e kandidaturës së tij për Drenasin, ka përmendur emrin e ish-deputetes, anëtares së Kryesisë së PDK-së, Safete Hadërgjonaj, se: “në kryesi të PDK-së ka edhe anëtar kryesie me 185 vota si dega në Deçan”. E në lidhje me këtë ka reaguar të martën në “Facebook”, Safete Hadërgjonaj. Ajo ia ka bërë me dije Lladrovci se pesë herë ka qenë deputete e Kuvendit të Kosovës dhe se në çdo kuvend të partisë ka dalë një nga gratë më të votuara me votë të fshehtë të delegatëve të partisë nga e gjithë Kosova. “Po, Ramiz unë jam anëtarja e kryesisë së PDK-së për 23 vite me radhë, sepse në çdo kuvend të partisë kam dalë një nga gratë më të votuara me votë



të fshehtë të delegatëve të partisë nga e gjithë Kosova. Jam një nga anëtarët me të devotshëm që kam punuar dinjitetshëm në PDK që nga viti 1999 kur është themeluar partia. Kam dhënë kontribut në themelimin e PDK-së, GDK-së, RDK-së anë e mbanë Kosovës. Mirënjohje dhe respekt për të gjithë ata anëtarë të partisë që kanë vlerësuar punën time duke më votuar në strukturat e partisë dhe pesë herë ma kanë

mundësuar me qenë deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës për të dhënë kontributin politik e profesional në interes të qytetarëve të Kosovës”, ka shkruar ajo në “Facebook”. Hadërgjonaj ia ka kujtuar Lladrovci angazhimin e saj në PDK që nga themelimi, sidomos për angazhimin e saj në Deçan, kur Lladrovci në një mënyrë ofendon ata votues të PDK-së. “Në shkurt të vitit 2000 kemi

themeluar PDK në Deçan bashkë me njerëz me plotë bagazh atdhetar e profesional. Jam mirënjohëse deri në pafundësi për themeluesit e degës dhe për të gjithë ata të rinj e të reja që na u bashkëngjiten gjatë rrugëtimit duke i dhënë frymë PDK në Deçan. Kur ne si degë jemi përballur e me çfarë nuk jemi përballur në një komunë tradicionale dhe bastion të një subjekti tjetër politik siç ishte AAK, ku ishte ti Ramiz??? Ishe pjesë e AAK-së, subjektit që në atë kohë ushtronte lloj-lloj presioni që mos të ketë PDK në Deçan. Por ne nuk jemi thye, sfidat i kemi shndërruar në mundësi e vështirësitë në vullnet për punë me bindjen se vetëm me PDK do të kemi shtetformim dhe shtetndërtim”, ka pohuar ajo. Hadërgjonaj ka thënë se punon pa u lodhur edhe sot që PDK-ja në këto zgjedhje lokale ta kthejë traditën e fitoreve nëpër

komuna. “Unë ndihem mirë që bashkë me anëtarët tjerë të degës së PDK në Deçan, i kemi mundësuar PDK-së me pas shtrirje në krejt Kosovën e mos me qenë parti regjionale dhe kemi kontribuar që projektet zhvillimore për Komunën e Deçanit të trajtohen me prioritet kur kemi qeverisë me vendin për interes të qytetarëve të Deçanit. Po ndihem mirë edhe kur po ma përmend emrin në media, sepse jam një nga ata anëtarët e kryesisë që nuk i frikësohem marrjes së vendimeve të vështira, jeta dhe veprimtaria në interes të vendit kështu më ka mësuar. Punoj pa u lodhur edhe sot që PDK-ja në këto zgjedhje lokale të kthejë traditën e fitoreve nëpër komuna, sepse siç thoshte kryetari ynë i nderuar Kadri Veseli ‘Kur ndalet PDK ndalet Kosova’. Na priftë e mbara #PDK191!”, ka shkruar anëtarja e Kryesisë së PDK-së, Safete Hadërgjonaj.

PËRURORHEN 15 SHËRBBIME TË REJA NË POLIKLINIKËN SPECIALISTIKE NË PODUJEVË

PODUJEVË, 23 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, bashkë me ministrin në detyrë të Shëndetësisë, Arben Vitia dhe kryetarin e komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, kanë bërë përrurimin e shërbimeve të reja në Poliklinikën Specialistike në Podujevë. Me këtë rast, kryeministri Kurti theksoi rëndësinë dhe nevojën e kahershme për hapjen e kësaj poliklinike specialiste për

qytetarët e Podujevës. “Investim shumë i rëndësishëm për Podujevën, për trevën e Llapit. Ky institucion shëndetësor tashmë është i gatshëm të ofrojë shërbime të specializuara për qytetarët, duke shmangur nevojën për udhëtime në Prishtinë për çdo vizitë specialiste”, tha ai. Nga sot në këtë poliklinikë do të ofrohen 15 shërbime të reja specialiste të cilat përfshijnë: interniste (kardiologji,



reumatologji, endokrinologji, hematologji, gastroenterologji dhe nefrologji), kirurgjike (kirurgjinë abdominale, torakale, urologji, vaskulare dhe ortopedi),

ginekologji, pediatri, pulmologji, neurologji, analiza laboratorike dhe shërbimi i radiologjisë. Vlora e përgjithshme e investimeve për këtë institucion shëndetësor arrin afër 2.43 milionë euro. Ndërkaq, kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, tha se ky është një moment i gëzueshëm për të gjithë qytetarët e komunës së Podujevës dhe se ai vetë është i lumtur që bashkëqytetarët e tij nuk do të kenë më nevojë të

udhëtojnë për në Prishtinë për t’i marrë shërbimet që nga sot mund t’i marrin në Poliklinikën Specialiste. Ai falënderoi kryeministrin, ministrin dhe drejtuesit e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës për mbështetjen. Muajin e kaluar në këtë poliklinikë është bërë edhe përrurimi i Repartit të Hemodializës, shërbim ky që po ofrohet për herë të parë në komunën e Podujevës.

Gërvalla në ShBA për Javën e Nivelit të Lartë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ka udhëtuar për në Nju-Jork në kuadër të Javës së Nivelit të Lartë të sesionit të 80 të Asamblesë së

Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Gjatë kësaj jave ministrja Gërvalla do të zhvillojë një sërë takimesh me përfaqësues të lartë të shteteve dhe organizatave ndërkombëtare, ku do të adresohen sfidat më të

rëndësishme të rendit global, nga siguria e çështjet rajonale e deri te zhvillimi ekonomik dhe forcimi i bashkëpunimit mes shtetesh. Ministrja Gërvalla do të jetë pjesë aktive e tryezave shumëpalëshe rreth politikave

globale të sigurisë, dinamikave gjeopolitike dhe sfidat në vitet në vijim. Në vazhdimësi, Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar ndaj paqes, stabilitetit dhe të ardhmes së rendit ndërkombëtar.



DHUNA NË SHKOLLA: KUR FRIKA ZË VENDIN E MËSIMIT

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Shtatori solli fillimin e vitit të ri shkollor në Kosovë, por për shumë nxënës klasat nuk janë më vende ku mund të mësohesh paqësisht. Çdo ditë ka fëmijë që shkojnë në shkollë me frikë, duke e ditur se një fjalë e gabuar ose një veprim i vogël mund të kthehet në dhunë fizike apo bullizim.

Një djalë rreth 10 vjeç e përjetoi këtë vitin e kaluar shkollor. Nëna e tij nuk dëshiron të identifikohet, e frikësuar se nëse dikush mëson se kush është djali, situata mund të përkeqësohet dhe dhuna të vazhdojë. “Problemi filloi për shkak të bankës. Djali ishte ulur në bankën e dytë dhe dy djem të tjerë të klasës i kërkuan ta lëshonte vendin, por ai nuk pranoi. Djali ishte vetëm kundër dy të tjerëve. Filluan me fjalë, pastaj u shtynë dhe përfunduan me dhunë fizike”, rrëfen kjo nënë për “Radion Evropa e Lirë”. “Edhe sot ata e bullizojnë kohë pas kohe”, thotë ajo.

Tronditja dhe brenga e saj janë të dukshme. Ajo nuk pranon ta zbulojë mënyrën se si ka reaguar udhëheqja e shkollës, nga frika se fëmija mund të jetë përsëri në rrezik. E ky rast nuk është i izoluar. Dhuna në mes të bashkëmoshatarëve në shkollat në Kosovë dhe përreth tyre është bërë një realitet i përditshëm, ku nxënësit përballen me bullizim, intimidim dhe sulme fizike, ndërsa institucionet shpesh mbeten të pafuqishme për ta ndaluar.

Muajin e kaluar opinioni u trondit nga rrahja e një 13-vjeçareje në Gjilan nga disa bashkëmoshatare të saj.

Në vitin 2022 “Radio Evropa e Lirë” raportoi edhe për rastin e vdekjes së një 14-vjeçari, pasi u ther me thikë në një shkollë në Prishtinë.

“REL”-i pyeti Policinë e Kosovës për incidentet në shkolla këtë dhe vitin e kaluar, por ende nuk mori përgjigje, ndërsa nga të dhënat e mëparshme, fenomeni po rritet.

Dhuna në shkolla në shifra

Në vitin 2023 një studim i publikuar nga një grup ekspertësh - kosovarë dhe të huaj - nxori në pah se nxënësit e shkollave fillore në Kosovë përjetojnë forma të ndryshme dhune - nga shtyrja apo rrahja deri te prekja pa dëshirë. Sipas të njëjtit raport,



shënjestra e viktimave të dhunës dallon mes vajzave dhe djemve. Sipas një sondazhi që realizoi organizata Save the Children Kosova në vitin 2021, 35 për qind e fëmijëve të anketuar kanë thënë se janë ndier të bullizuar ose të ngacmuar për shkak të pamjes së jashtme, aftësisë së kufizuar, religjionit, orientimit seksual, statusit ekonomik dhe arsyeve të tjera.

Se kjo dukuri është e vazhdueshme, dëshmon edhe një raport i Avokatit të Popullit i para rreth një dekade.

Në atë hulumtim me 385 nxënës shqiptarë dhe serbë në Prishtinë dhe në Graçanicë, një e treta e tyre raportuan se kishin qenë viktimë të ngacmimeve në shkollë gjatë muajve të fundit. Sipas raportit, 4 % thanë se ishin ngacmuar dy ose tri herë në muaj, 7 % dy ose tri herë në javë, 2 % një herë në javë dhe 5 % disa herë në javë.

Institucionet, mes përpjekjeve dhe mungesës së veprimit

Për Avokatin e tanishëm të Popullit, Naim Qelaj, situata është alarmante. Ai thotë se dhuna është e pranishme jo vetëm mes bashkëmoshatarëve, por edhe mes nxënësve dhe mësimitdhënësve, megjithëse më së shumti shfaqet ndërmjet vetë nxënësve. Përveç kësaj, ai thotë se ka një mospërputhje të madhe mes rasteve të raportuara nga shkollat, policia dhe institucionet e tjera - çka tregon, sipas tij, se problemet shpeshherë

minimizohen ose nuk dokumentohen siç duhet.

Qelaj thotë se institucionet e sigurisë dhe ato arsimore janë të vetëdijshme për situatën, por se mungojnë veprimet konkrete. “Shteti duhet të ketë një politikë gjithëkombëtare për ta ndaluar këtë problematikë”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Kosovës pranon se dhuna në shkolla është një problem shqetësues, të cilin ajo e lidh me faktorë individualë, familjarë dhe socialë.

Nga ky institucion thonë se kanë ndërmarrë hapa përmes legjislacionit dhe politikave për mbrojtjen e fëmijëve, përfshirë trajnimin e pikave të kontaktit në shkolla. “MASHTI, përveçse ka Rregulloren mbi Protokollin për parandalim dhe Referim të Dhunës [21/2013], ka zhvilluar manuale didaktike për ta trajtuar dhe parandaluar dhunën përmes edukimit”, thuhet në përgjigjen me shkrim të MASHTI-t për “Radion Evropa e Lirë”. Aty nuk jepen hollësi për ndikimin në praktikë të këtyre rregulloreve apo manualeve.

Përndryshe, në Kosovë funksionojnë edhe këshillat drejtues të shkollave që, sipas ligjit, kanë rol të rëndësishëm në përcaktimin e politikave dhe funksionimin e shkollës. Por, ndikimi i tyre në praktikë nuk është dhe aq i dukshëm, thotë për “Radion Evropa e Lirë” kryesuesi i Këshillit Drejtues të Shkollës Fillore “Pavarësia” në Prishtinë, Bujar Pervetica. Sipas tij, gati asnjë nxënës nuk i shpëton

ekspozimit ndaj dhunës psikologjike. “Pa përjashtim, nxënësit përballen çdo ditë me dhunë psikologjike nga bashkëmoshatarët. Ka raste të izoluara kur edhe mësimitdhënësit janë të përfshirë, por ato zakonisht zgjidhen shpejt”, shpjegon ai.

Sipas Perveticës, dhuna shpesh shfaqet si një hierarki e brendshme mes nxënësve, ku më të rriturit ushtrojnë presion mbi më të vegjëlit. “Nxënësit e klasave të teta shpesh përpiqen të vendosin autoritet mbi nxënësit e klasave të gjashta, për shembull”, thotë ai, duke shtuar se pas kësaj fshihet një mungesë e madhe e ndërveprimit institucional. Ai thotë se shkollat nuk e kanë mbështetjen e duhur as nga prindërit, as nga institucionet, dhe shpesh lihen të përballen vetë me probleme që kërkojnë zgjidhje sistematike.

Qëndrim të ngjashëm ndan edhe sociologu Besim Gallopi. Ai thotë se mungesa e bashkëpunimit ndërmjet familjes, shkollës dhe komunitetit e bën situatën edhe më të rëndë. Në shumë raste viktimat dhe agresorët mbeten të vetmuar, pa mbështetje dhe pa një rrjet sigurie që do të duhej t'i orientonte drejt sjelljeve pozitive, sipas tij.

Kur ky ‘trekëndësh’ mungon, Gallopi thotë se nxënësit shpesh ndihen të braktisur dhe reagojnë me dhunë ndaj bashkëmoshatarëve. Gallopi thotë se zgjidhja nuk mund të vijë vetëm nga një institucion - MASHTI dhe shkollat duhet ta rrisin bashkëpunimin,

sipas tij. “Nevojitet përgatitja e udhëzuesve dhe rregulloreve adekuate, si dhe zbatimi i tyre”, thotë ai për “Radion Evropa e Lirë”.

Mësimet nga përvojat ndërkombëtare

MASHTI, ndërkohë, ka paralajmëruar programe të reja edukimi dhe trajnimi për mësimitdhënësit dhe psikologët shkollorë, por mbetet të shihet nëse këto iniciativa do të përktihen në rezultate konkrete në terren. Raportet e organizatave të ndryshme joqeveritare tregojnë se fushatat e ndërgjegjësimit, të zhvilluara ndër vite, nuk kanë arritur të japin efekte të qëndrueshme.

Sipas një raporti të Organizatës për Arsim, Shkencë dhe Kulturë të Kombeve të Bashkuara (UNESCO), të publikuar në vitin 2019, pothuajse një në tre nxënës (32 %) është ngacmuar nga bashkëmoshatarët e tij në shkollë të paktën një herë gjatë muajit të fundit.

Në Evropë, ashtu si edhe në Amerikën e Veriut, ngacmimi psikologjik është lloji më i zakonshëm i ngacmimit. “Fëmijët që perceptohen si ‘ndryshe’ në çfarëdo mënyre kanë më shumë gjasa të ngacmohen”, thuhet në këtë raport.

Bazuar në studimet e rasteve të gjashtë vendeve që kanë pasur sukses në uljen e dhunës dhe ngacmimit në shkollë - Esvatini, Italia, Xhamajka, Libani, Republika e Koresë dhe Uruguai - dhe dy vendeve që kanë mbajtur nivele të ulëta me kalimin e kohës - Holanda dhe Suedia - ekzistojnë disa faktorë që kontribuojnë në përgjigje efektive kombëtare, thuhet në raportin e UNESCO-s. Në mesin e tyre është udhëheqja politike dhe angazhimi i nivelit të lartë, së bashku me një kuadër të fuqishëm ligjor dhe politik, që adreson dhunën kundër fëmijëve dhe ngacmimin në shkollë.

Pastaj vijnë partneritetet dhe bashkëpunimi mes palëve të interesuara në komunitetin shkollor, përfshirë: drejtorët e shkollave, mësuesit, stafin tjetër, prindërit dhe nxënësit, autoritetet lokale dhe profesionistët në sektorë të tjerë.

Si faktorë me ndikim pozitiv përmenden, gjithashtu, trajnimi dhe mbështetja për mësuesit dhe kujdesi dhe mbështetja për nxënësit e prekur.

Kurti refuzon të flasë për formimin e qeverisë

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka refuzuar të përgjigjet nëse Lëvizja Vetëvendosje ka zhvilluar takime me partitë e tjera për t'i siguruar votat për formimin e qeverisë.

Kurti para gazetarëve gjatë përrurimit të 15 shërbimeve në

Poliklinikën Specialistike të Podujevës tha të martën se “këtu jemi në poliklinikë”. Gjykata Kushtetuese më 5 shtator njoftoi se ka pranuar kërkesën e Listës Serbe për vendosjen e një mase të përkohshme lidhur me procesin e zgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit nga

komuniteti serb, duke vendosur që ajo të mbetet në fuqi deri më 30 shtator 2025. Në aktvendimin e publikuar thuhej se kjo masë ka për qëllim pezullimin e afatit 30 ditor për konstituimin e Kuvendit, i përcaktuar më herët nga një vendim i Kushtetueses. Dimal Basha u zgjodh kryetar i

Kuvendit të Kosovës në seancën e 26 gushtit, pas pothuajse gjashtë muajsh nga mbajtja e seancës së parë për konstituimin e Kuvendit, ndërkohë që zgjedhjet parlamentare ishin mbajtur më 9 shkurt.

Megjithatë, pavarësisht prej këtij hapi të rëndësishëm,



institucioni legjislativ sërish ngeci në zgjedhjen e të gjithë nënkryetarëve.

AUDITORJA E PËRGJITHSHME REKOMANDON KOORDINIM NDËRINSTITUCIONAL PËR RUAJTJEN E HAPËSIRAVE PYJORE TË KOSOVËS

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, mori pjesë në ngjarjen e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK), ku ishin të pranishëm përfaqësues të komunitetit të biznesit, anëtarë të OEAK-ut, institucioneve financiare si dhe përfaqësues nga Ambasada Amerikane në Kosovë në kuadër të avancimit të dialogut institucional me organizatat profesionale, shoqatat dhe palët e interesit në fushat me interes të përbashkët publik. Stabiliteti i sektorit financiar, ecuritë kryesore makroekonomike, aktivitetet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) në kuptim të reformave kyçe strategjike, si dhe avancimi kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, ishin disa nga temat e diskutimit ndërmjet guvernatorit Ismaili me anëtarëve të OEAK-ut. Ai elaboroi zhvillimet në sektorin bankar, duke konfirmuar



adekuatshmërinë kryesore të shëndetshmërisë së bankave, përfshirë nivelin e kapitalizimit, likuiditetit dhe stabilitetit të sistemit financiar në përgjithësi. Gjithashtu, guvernatori Ismaili paraqiti veprimet e ndërmarra nga BQK-ja në drejtim të avancimit të sistemit të pagesave, përfshirë lehtësirat e pritshme për bizneset nga

anëtarësimi i Kosovës në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), si dhe zhvillimet lidhur me projektin për krijimin e sistemit të pagesave të shpejta - TIPS Clone, si infrastrukturë e rëndësishme për gjithë ekonominë. Këto iniciativa u mirëpritën dhe u mbështetën nga anëtarët e OEAK-ut të cilët u dakorduan për

rëndësinë e komunikimit ndërinstitucional dhe nevojën për të pasur progres në këtë aspekt, me theks anëtarësimi në SEPA. Duke falënderuar për ftesën e drejtorit ekzekutiv të Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, guvernatori Ismaili e vlerësoi të rëndësishme platformën e diskutimit me

përfaqësues të sektorit privat, me qëllim të kuptimit sa më të drejtë të sfidave, duke rritur rolin e tyre si kontribuues të rëndësishëm në ekonominë e vendit dhe në sektorin financiar. Më tutje, ai u angazhua në diskutime me pjesëmarrësit në tema të ndryshme, përfshirë kornizën rregullative të sektorit financiar dhe qasjes në financa. U përmend nevoja e biznesit për avancimin e rregullativës për kanale alternative të financimit përmes tregut të kapitalit, mbështetjes së inovacioneve, si dhe nismave aktuale që mbështesin ndërkombëtarizimin dhe integritetin financiar të vendit me tregjet evropiane dhe ato amerikane. Nga ana e tij, drejtori Zeka falënderoi guvernatorin Ismaili për gatishmërinë për të diskutuar me përfaqësuesit e sektorit privat dhe shprehu përkushtimin e Odës për të kontribuar në një dialog konstruktiv me BQK-në, duke vlerësuar lart angazhimin dhe rezultatet e BQK-së në disa shtylla, duke u angazhuar në transparencë dhe komunikim të hapur ndërmjet institucioneve.

AUDITORJA E PËRGJITHSHME REKOMANDON KOORDINIM NDËRINSTITUCIONAL PËR RUAJTJEN E HAPËSIRAVE PYJORE TË KOSOVËS

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka realizuar auditimin e performancës “Mbrotjtja, zhvillimi dhe ripërtëritja e hapësirave pyjore”, për periudhën 2020-2024 i cili ka vlerësuar efikasitetin e institucioneve përgjegjëse në mbrojtjen, zhvillimin dhe ripërtëritjen e hapësirave pyjore. Rezultatet e këtij auditimi tregojnë se institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të menaxhojnë në mënyrë të duhur hapësirat pyjore në Kosovë. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) nuk ka arritur të përgatisë dhe t’i miratojë udhëzimet administrative të nevojshme për menaxhimin e pyjeve, për rrjedhojë Agjencia Pyjore e Kosovës operon pa kornizë të plotë rregullative.

Po ashtu, Agjencia Pyjore e Kosovës nuk ka bërë inventarizim të plotë dhe të përditësuar të pyjeve si dhe nuk ka organizuar në mënyrë efektive mbrojtjen e pyjeve publike, prandaj nuk ka të dhëna të sakta për gjendjen aktuale të resurseve pyjore. Auditimi ka evidentuar se rreth 44 % e objektivave të planifikuara nuk janë realizuar, ngecjet janë më të theksuara në kultivimin, trajtimin dhe ngritjen e pyjeve të reja. Rreth një milion fidanë në Institutin Pyjor të Kosovës rrezikojnë të dështojnë për shkak të mungesës së kontraktimeve për pyllëzim nga Agjencia. Në parqet “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri” janë regjistruar prerje të shumta ilegale dhe ndërtime pa leje. Në Parkun Kombëtar “Sharri”, mungesa e



rojeve pyjore ka bërë që deri në 70 % e territorit të mbetet pa mbrojtje. Ndërsa në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” problem i madh janë edhe ndërtimet ilegale dhe, sipas regjistrimeve të vitit 2024, janë mbi 6 083 ndërtime ilegale. Po ashtu, nuk ka të dhëna të sakta sa

i përket numrit të uzurpimit të pronave publike. Agjencia Pyjore për më shumë se 20 vjet nuk ka trajtuar çështjen e pronave që i ka në menaxhim. Ka rreth 500 prona me emërtime të ndryshme të cilat ende nuk i ka unifikuar dhe verifikuar. Gjithashtu, auditimi ka

evidentuar se në procesin e qiradhënies së pronave publike ka vonesa deri në 38 muaj si dhe janë bërë shumë shkelje nga qiramarrësit. Lidhur me këtë auditim, Auditorja e Përgjithshme Vlora Spanca deklaroi se mungesa e kornizës së qartë ligjore, kontrollit efektiv dhe koordinimit institucional kanë rezultuar me prerje ilegale, uzurpime dhe dëmtime të zonave të mbrojtura, duke shkaktuar humbje të mëdha ekonomike dhe mjedisore. Prandaj është i nevojshëm një koordinim ndërinstitucional me qëllim të ruajtjes, zhvillimit dhe ripërtëritjes së hapësirave pyjore të vendit. Për përmirësimin e gjendjes së pyjeve në Republikën e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 11 rekomandime.

ASK: Deficit tregtar prej 7,7 % në muajin gusht 2025 krahasuar me gusht 2024

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin gusht 2025.

Të dhënat nga tregtia e jashtme e mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 7,7 % në muajin gusht 2025, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2024, gjegjësisht në vlerë prej

536,8 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 498,5 milionë euro në vitin 2024. Eksporti mbulon importin me 12,4 %. Eksporti i mallrave në muajin gusht 2025 kishte vlerën 76,2

milionë euro, ndërsa importi rënie prej (-8,7 %) për eksport, si dhe një rritje prej 5,3 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.



ORSON WELLES, GJENIU REBEL I KINEMASË

Ishte në çdo gjë një personazh i tepruar, pa limite, i madhështor, si në gjenialitetin e tij të padiskutueshëm aktorial, ashtu edhe në karakterin e pamundur dhe në përmasat trupore: George Orson Welles, i quajtur The Great One (ishte 1,83 m i gjatë), ka qenë një nga autorët, aktorët dhe regjisorët më të mëdhenj të kinemasë amerikane. Lindi në Kenosha, Wisconsin, më 6 maj 1915 nga Richard Head Welles, shpikës dhe biznesmen, dhe Beatrice Ives, pianiste dhe qitëse e talentuar. Familja, e pasur dhe kozmopolite, përzierte origjinat gjermane, irlandeze dhe skoceze.

I jashtëzakonshëm

Orson ishte një fëmijë i mrekullueshëm: luante piano dhe violinë, aktronte, pikturonte, shkruante poezi, fliste frëngjisht shumë mirë dhe argëtonte miqtë me lojëra magjie dhe me skena të shkurtra nga Shekspiri. Por prindërit u ndanë kur ai ishte katër vjeç dhe e ëma vdiq kur ai ishte vetëm nëntë. Në vitin 1926, Welles hyri në shkollën ekskluzive Todd School në Woodstock, Illinois, një shkollë eksperimentale ku mundi të shfaqte talentin e tij të hershëm në skenën shkollore. Kur edhe babai vdiq, në vitin 1930, u mor nën kujdes nga një mik i familjes, mjeku Maurice Bernstein. Pas diplomimit nuk vazhdoi studimet universitare, por ndoqi për pak kohë Art Institute of Chicago përpara se të transferohej në Dublin për t'iu përkushtuar teatrit. Me teatrin e sapokrijuar Gate Theatre, ku hyri duke trilluar një eksperiencë që nuk e kishte, pati një sukses të jashtëzakonshëm. Qëndroi një vit, më pas kaloi në Londër dhe Nju Jork, përpara se të bënte një udhëtim të gjatë mes Marokut dhe Spanjës. Vetëm në vitin 1934, me debutimin në Nju

Jork në rolin e Tebaldos në një vënie në skenë të Romeo dhe Zhulieta, karriera e tij mori hov, falë edhe popullaritetit tashmë të fituar në radio, për zërin e tij të thellë dhe të dallueshëm. Më 30 tetor 1938, tashmë i martuar dhe baba i vajzës së vogël Christopher, shkaktoi “skandal” duke interpretuar një lajm të rremë radiofonik, i cili rrëfente drejtpërdrejt, me një tension në rritje, zbarkimin e marsianëve armiqësorë në New Jersey. Ishte një adaptim gjenial i romanit të H.G. Wells Lufta e Botëve, por transmetimi – në praktikë fake news-i i parë mediatik i historisë – shkaktoi panik të madh mes dëgjuesve. Suksesi që i jashtëzakonshëm dhe i hapi atij dyert e Hollywood-it, me të cilin, megjithatë, Welles nuk pati kurrë marrëdhënie të lehta. Në vitin 1939, ai firmosi një kontratë të jashtëzakonshme me shtëpinë e prodhimit RKO, e cila në letër i garantonte autonomi pothuajse të plotë, por në realitet nuk ndodhi kështu. Për debutimin e tij kinematografik, Welles ëndërronte të sillte në ekran “Zemra e errësirës” të Conrad-it, por projekti nuk u realizua. Fama, të paktën ajo pas vdekjes (meqë publiku nuk e shpërbleu kurrë), erdhi vetëm në vitin 1941 me “Citizen Kane”, film që ai e shkroi, e drejtoi, e prodhoi dhe e interpretoi vetë, dhe që sot konsiderohet një kryevepër. Vetëm 26-vjeçar, Welles imponoi stilin e tij personal, të bazuar në xhirimet bardhë e zi dramatik, xhirime nga poshtë, muzikë ngacmuese, dialogë të shpejtë e të mbivendosur, lëvizje të gjata kamere dhe xhirime të guximshme me vinq: një nga debutimet më të bujshme në historinë e kinemasë. Në film ai interpretonte Charles Foster Kane, një manjat të paskrupullt të shtypit (i frymëzuar nga botuesi William R. Hearst), i cili, nisur nga origjinë modeste, grumbullon një pasuri



të pamasë nga e cila nuk arrin të gëzojë, i mposhtur nga ambicia e tij verbuese. “Rosebud”, slita e famshme prej druri që shfaqet në skenat finale të filmit, simbolizon mallin për pafajësinë e humbur të fëmijërisë dhe këtë vit është shitur në ankand për 14,75 milionë dollarë. Kane ishte vetëm i pari nga shumë personazhet problematikë që Welles adhuronte të rrëfente: figura të ngritura dhe të rrënuara nga veset dhe pasionet e trishtueshme – si George tek The Magnificent Ambersons (1942), Macbeth (1948), Otello (1951), Gregory Arkadin tek Confidential (1955), detektivi Hank (1958), Falstaff (1965) dhe Jake Hannaford tek The Other Side of the Wind. Ky i fundit, i xhiruar mes viteve 1970 dhe 1976 bashkë me regjisorë dhe miq si Peter Bogdanovich dhe John Huston, u përfundua dhe u shpërnda vetëm në vitin 2018.

Detaje të errëta

Lista e projekteve të nisura që kurrë nuk u përfunduan është mbresëlënëse: gjithmonë në

konflikt apo në gjyq me drejtuesit e studiove dhe gjithnjë pa para, Welles u përkul ndaj gjithçkaje, pranoi edhe role të vogla e absurde vetëm që të mbledhte disa dollarë për filmat e tij dhe për familjen e gjerë. Ai u martua tri herë, me Virginia Nicolson, Rita Hayworth dhe Paola Mori, nga të cilat pati tre vajza. Me Hayworth, me të cilën punoi tek Zonja e Shangait (1948), marrëdhënia ishte më e trazuara: madje e detyroi të priste dhe t'i lyente biond platin flokët e saj të kuq. Por mbi filmin rëndonin edhe hije të tjera: Harry Cohn, bosi i Columbia Pictures, urdhëroi të priteshin disa skena finale të xhiruara në Luna Park, sepse manekininë e gjymtuar që shfaqeshin aty i kujtonin vrasjen e aktorese Elizabeth Short, trupi i zhveshur dhe i sakatuar i së cilës, i prerë në dysh, ishte gjetur buzë një rruge periferike në Los Angeles në vitin 1947. Krimi, i njohur si rasti “Dahlia e Zezë”, tronditi Amerikën dhe nuk u zbardh kurrë. Në vitin 1999, Mary Pacios, një mike fëmijërie e viktimës, në një libër arriti ta akuzonte hapur Welles për vrasjen, për shkak të

“fiksimit të tij për të prerë gjithçka më dysh”. I munduar nga demonët e tij, regjisori kishte treguar njëherë për David Frost se ishte bërë aq i aftë si magjistar dhe si fallxhor, saqë pothuajse i trembej vetvetes. Në vitin 1977, George Lucas donte që Welles t'i jepte zërin Darth Vader-it në Star Wars, por më pas hoqi dorë; megjithatë e deshë si zërin rrëfyes të trailer-ave.

Fjalët e fundit

Regjisor i vdiq në Hollywood, më 10 tetor 1985, i goditur nga një atak në zemër, pak pas pjesëmarrjes në Merv Griffin Show: në atë kohë peshonte mbi 160 kg, për shkak të pasionit për biftekë të gjakosur dhe uiski skocez. Hiri i tij u vendos në një pus të mbuluar me lule në haciendën e toreros Antonio Ordóñez, në Ronda, Spanjë, ku Welles kishte kaluar kohë të lumtura dhe që e konsideronte strehën e tij të fundit. Në një nga batutat e tij të famshme, por dhe shumë therëse kishte deklaruar: «Nuk lutem, sepse nuk dua ta mërzis Zotin». / bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Rrahmani, i gatshëm për Milanin

NAPOLI, 23 SHTATOR - Kapiteni i Kombëtares së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, do të jetë plotësisht i gatshëm për ndeshjen e radhës te skuadra e Napolit. Madje Rrahmani pritet të rikthehet titullar dhe atë në derbin kundër Milanit, ndeshje

kjo që luhet të dielën mbrëma në stadiumin “San Siro” dhe i takon xhiros së pestë. Rrahmani i ka munguar Napolit në tri ndeshjet e fundit në të gjitha garat për shkak të lëndimit që e pësoi në duelin ndërmjet Zvicër dhe Kosovës në kuadër të kualifikimeve për

Botërorin 2026. Mbrojtësi kosovar tashmë është rikuperuar plotësisht dhe ishte në ekipin e Napolit për ndeshjen ndaj Pisas, që e fitoi 3:2, por nuk u aktivizua nga trajneri Antonio Conte. Rrahmani nuk ka luajtur te Napoli kundër Fiorentinas e

Pisas në kampionat, si dhe Manchester Cityt në Ligën e Kampionëve. Napoli është lider në Serinë A, me katër fitore në po aq ndeshje të zhvilluara, dhe ka tri pikë më shumë se Milani, ekip ndaj të cilit do të rikthehet Rrahmani në fushë.



OUSMANE DEMBELE SHPALLET FITUES I “TOPIT TË ARTË”

PARIS, 23 SHTATOR - Ylli francez i futbollit, Ousmane Dembele, është shpallur fitues i “Topit të Artë” 2025, duke u kurorëzuar lojtari më i mirë i botës pas një sezoni historik me Paris Saint-Germain (PSG), ndërsa “Topin e Artë” për femra e ka fituar Aitana Bonmati. Francezi triumfoi ndaj rivalëve të fuqishëm si Kylian Mbappé, Mohamed Salah dhe Lamine Yamal. Nën drejtimin e Luis Enrique, Dembélé ishte protagonist i kryesor në sezonin e artë të PSG-së, duke fituar Ligën 1, Kupën e Francës dhe, mbi të gjitha, Ligën e Kampionëve. Me driblimet e tij spektakolare, shpejtësinë shpërthyesë dhe golat vendimtarë, ai u shndërrua në armën kryesore të parizienëve. Statistikat e tij flasin vetë: 37 gola dhe 16 asiste në të gjitha garat, duke e bërë një nga lojtarët më produktivë të



Evropës. Kulmi i tij erdhi në finalen e Ligës së Kampionëve, ku shkëlqeu duke udhëhequr PSG-në drejt trofeut të parë historik në këtë kompeticion. Ky triumf është edhe një shpërblim personal për karrierën e Dembeles, i cili për vite me radhë është përballur me lëndime dhe kritika, por ka ditur të kthehet fuqishëm dhe ta arrijë majën e futbollit

botëror. Me “Topin e Artë” në dorë, Ousmane Dembele hyn në historinë e futbollit si simbol i talentit, këmbënguljes dhe rikthimit madhështor. Pas pranimit të këtij çmimi, Dembele ka falënderuar të gjithë ata që e kanë mbështetur në këtë rrugëtim historik. “Faleminderit të gjithëve! Është e pabesueshme ajo që më

ndodhi. Jam pa fjalë. Ka qenë një sezon i jashtëzakonshëm me PSG-në dhe kam përjetuar gjëra të mrekullueshme. Të fitosh këtë trofe dhe që Ronaldinho të ma dhurojë është diçka e jashtëzakonshme”, ka thënë Dembele, duke e vlerësuar në veçanti klubin parisien dhe trajnerin Luis Enrique, pasi ka arritur kulmin me PSG-në. Dembele nuk ka harruar as

etapat e tjera të karrierës së tij, duke i falënderuar edhe klubet ku ka luajtur. Francezi e ka përmbyllur fjalimin me një mesazh të ngrohtë për njerëzit më të afërt. “Faleminderit familjes sime, nënës sime, agjentit tim dhe shokut tim më të mirë që ka qenë gjithmonë pranë meje. Ky trofe është edhe i tyre”, ka thënë Dembele.

Fituesit në ceremoninë e “Topit të Artë”:

“Topi i Artë” për meshkuj, **Ousmane Dembele**
“Topi i Artë” për femra, **Aitana Bonmati**
Portieri i Vitit, **Gianluigi Donnarumma**
Talent i mirë U-21, **Lamine Yamal**
Trajneri i Vitit, **Luis Enrique**
Trajnerja e Vitit, **Sarina Wiegman**
Sulmuesi më i mirë, **Viktor Gyokeres**
Sulmuesja më e mirë, **Ewa Pajor**
Klubi i Vitit, **Paris Saint-Germain (PSG)**
Klubi i Vitit për femra, **Arsenal Women**

ZHEGROVA PRITET TË JETË TITULLAR NDAJ ATALANTAS

Torino, 23 shtator - Gjasat janë shumë të mëdha që Edon Zhegrova të jetë startues te Juventusit në ndeshjen e radhës në kampionatin italian. Juventusit të shtunën prej orës 18:00 e pret në shtëpi skuadrën e Atalantas në kuadër të xhiros së pestë në Serinë A. E pikërisht në këtë ndeshje, Zhegrova të luajë prej minutës së parë pasi trajneri Igor Tudor pritet të bëjë ndryshime në formacion. Në fakt, Tudor do t’i pushojë disa prej sulmuesve që kanë pasur minutazhë më të madhe pasi shfaqën lodhje në ndeshjen e fundit ndaj Veronas, në të cilën Juventusit barazoi 1:1. Zhegrova në këtë përballje ishte inkuadruar në minutën e 83-të për ta



bërë debutimin e tij zyrtar në kampionat, ndërsa ditë më parë luajti edhe në Ligën e Kampionëve kur kishte ndikim në barazimin e Juventusit 4:4 ndaj Borussia Dortmundit. Zhegrova këtë verë është transferuar te Juventusit, ekip që pas katër xhirove në kampionatit italian zë vendin e dytë në tabelë me 10 pikë të grumbulluara.

“JAVA E GRASSROOTS”-IT NIS NË MITROVICËN E VERIUT

MITROVICË, 23 SHTATOR - Në Mitrovicën e Veriut ka nisur të hënën “Java e Grassroots” si një fillim i mbarë i një shprese të re. Të rinj e të reja i janë bashkuar kësaj ngjarje në fushë për të ndërtuar ura që vetëm futbollit mund t’i krijojë. Me këtë rast presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka thënë për “Grassroots” nuk është vetëm lojë futbollit, por është edukim, zhvillim dhe bashkim. “Me futbollin si gjuhë të përbashkët të respektit, e nisëm ‘Javën e Grassroots’-it në Mitrovicën e Veriut. Kënaqësi dhe nder i veçantë të jem pjesë e këtij aktiviteti, ku fëmijët u bashkuan në fushë për të përjetuar emocionin që



vetëm futbollit mund ta sjellë. Grassroots nuk është vetëm lojë futbollit, është edukim, zhvillim dhe bashkim. Është themeli mbi të cilin ndërtojmë një të ardhme më të mirë për fëmijët tanë – futbollistët e së ardhmes. FFK-ja do të vazhdojë me përkushtim të mbështesë projekte të tilla kudo në Kosovë, sepse besojmë se çdo fëmijë meriton të rritet me vlerat që i mëson futbollit: respektin, bashkëpunimin dhe punën e palodhur. Sot ishte vetëm dita e parë. Java e Grassroots sapo ka nisur dhe FFK është përkujdesur që të ketë aktivitete gjithandej Kosovës!”, ka shkruar Ademi në “Facebook”.

Trepça eliminohet nga FIBA Champions League

SOFJE, 23 SHTATOR - Në një përballje të fortë kualifikuese të Basketball Champions League, skuadra holandeze Den Bosch ka eliminuar kampionen e

Kosovës, Trepçën, duke fituar me rezultat 80-68. Ndeshja është zhvilluar në Bullgari, në praninë edhe të Torcidës. Për Den Bosch, Kerwin

Walton dhe Menno Dijkstra spikaten me 13 pikë secili, ndërsa Keegan Veinot shtoi gjithashtu 13 pikë dhe kontribui mbrojtje të fortë.

Te Trepça më i dalluari ishte Jacori Payne me 15 pikë dhe 9 kërcime, i ndjekur nga Chad Brown me 11 pikë dhe 8 kërcime.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar/e për mbështetje të operimeve me Sistemet e Pagesave
Grada: P06
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Departamenti i Sistemit të Pagesave
Divizioni: Divizioni i Operimit të Sistemeve të Pagesave
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Operimit të Sistemeve

Përshkrim i detyrave dhe përgjegjësi:

- Kryen detyrat e parapara në kuadër të procedurave të punëve operacionale, në Sistemin e Pagesave-KIPS, si dhe sistemet tjera, ne kuadër të fushëveprimit të Departamentit;
- Koordinon aktivitetet me Departamentin e Teknologjisë Informative në BQK, në raste të ngritjes së problemeve të natyrës teknike/operacionale apo edhe zhvillimeve të reja;
- Bashkëpunon me kompanitë kontraktuese, në funksion të mirëmbajtjes së sistemeve, ngritjes apo zhvillimeve të funksioneve shtesë dhe testimeve të sistemeve ekzistuese;
- Ofron trajnime për pjesëmarrësit e rinjë dhe ndihmon në përgatitjen teknike për këta pjesëmarrës;
- Angazhohet në realizimin e detyrave për punë operacionale në sistemet e pagesave dhe sistemet tjera në kuadër të fushëveprimit të Departamentit, për rastet e jashtëzakonshme dhe ofron zgjidhje teknike;
- Angazhohet në draftimin e dokumenteve (rregullore, manuale të përdorimit, udhëzime teknike, procedura, etj) për sistemet në kuadër te fushëveprimit te Departamentit;
- Angazhohet në përgatitjen e raporteve, procedurave dhe standardeve të ndërlidhura me menaxhimin e rrezikut operacional;
- Duhet të jetë i/e njoftuar dhe angazhuar me të gjitha funksionet e sistemeve qe operohen nga Departamenti.;
- Komunikon dhe koordinon aktivitetet me departamentet dhe divizionet tjera të BQK-së lidhur me kërkesat dhe nevojat që rrjedhin për mbarëvajtjen e operacioneve;
- Komunikon dhe ofron konsultat sipas nevojës për pjesëmarrësit e sistemit të pagesave, si dhe për palët e treta;
- Monitoron dhe ofron zgjidhje për funksionet teknik që lidhen me sistemet.
- Angazhohet në përcjelljen e zhvillimeve të reja në fushën e shërbimeve të pagesave në BE e më gjerë, me standardet e mesazheve financiare, si dhe në analizimin dhe propozime për avancimin e funksioneve të sistemeve të pagesave;
- Angazhohet në monitorimin e veglave të ndryshme teknike të ndërlidhura me sistemet, si dhe përgatitjen e veglave për filtrim të raporteve të njëhershme nga baza e të dhënave;
- Sipas nevoje kryen punë të tjera të lidhura me sistemet që operohen në kuadër të DSP-së, të deleguara nga mbikëqyrësi apo hierarkia më lartë apo me obligimet që rrjedhin në kuadër të përgjegjësi në DSP dhe BQK.

Përgatitjet Profesionale/Kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e shkencave të IT-së, inxhinierisë dhe ekonomisë (drejtimet: menaxhment dhe informatikë apo banka dhe financa);
- Përvojë prej së paku dy (2) vite me aplikacione/sisteme kompjuterike, drejtpërdrejt të ndërlidhura me infrastrukturën për shërbimet e pagesave ndërbankare apo për shërbimet tjera financiare, me preferencë përvoja në sektorin bankar;
- Përparësi kanë kandidatët me përvojë dhe njohuri në administrimin dhe mbështetjen teknike të sistemeve të pagesave ndër-bankare si dhe mesazhet financiare të përdorura në këto sisteme;
- Shkathësi organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e problemeve dhe adaptim të shpejt me zhvillimet e reja;
- Saktësi, vëmendje në detaje, si dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të avancuara të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar;
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **09 tetor 2025**
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta : Službenik/ca za podršku operacijama platnih sistema
Stepen pozicije: P06
Trajanje zaposlenja: Na neodređeno vreme
Odeljenje: Odeljenje za platni sistem
Odsek: Odsek za operacije platnih sistema
Izveštava: Šefa Odseka operacije sistema

Opis dužnosti i odgovornosti:

- Obavlja zadatke predviđene u okviru operativnih radnih procedura, u Platnom sistemu-KIPS, kao i drugim sistemima, u okviru delokruga Odeljenja;
- Koordinira aktivnosti sa Odeljenjem za informacione tehnologije u CBK, u slučajevima nastanka tehničkih/operativnih problema ili novih razvoja;
- Sarađuje sa ugovornim kompanijama, u cilju održavanja sistema, uspostavljanja ili razvoja dodatnih funkcija i testiranja postojećih sistema;
- Pruža obuku za nove učesnike i pomaže u tehničkoj pripremi ovih učesnika;
- Uključuje se u izvršenju zadataka za operativni rad u platnim sistemima i drugim sistemima u okviru delokruga Odeljenja, za izuzetne slučajeve i pruža tehnička rešenja;
- Uključuje se u izradu dokumenata (propisa, korisničkih priručnika, tehničkih uputstava, procedura itd.) za sisteme u okviru delokruga Odeljenja;
- Uključuje se u pripremu izveštaja, procedura i standarda vezanih za upravljanje operativnim rizicima;
- Mora biti upoznat i uključen u sve funkcije sistema kojima upravlja Odeljenje;
- Komunicira i koordinira aktivnosti sa drugim odeljenjima i odsecima CBK u vezi sa zahtevima i potrebama koje se javljaju za nesmetano funkcionisanje poslovanja;
- Komunicira i pruža konsultacije po potrebi učesnicima platnog sistema, kao i trećim licima;
- Prati i pruža rešenja za tehničke funkcije vezane za sisteme.
- Uključuje se u praćenje novih razvoja u oblasti platnih usluga u EU i šire, sa standardima finansijskih poruka, kao i analizira i predlaže predloge za unapređenje funkcija platnog sistema;
- Uključuje se u praćenje različitih tehničkih alata vezanih za sisteme, kao i pripremom alata za filtriranje jednokratnih izveštaja iz baze podataka;
- Po potrebi, obavlja i druge zadatke vezane za sisteme koji se koriste u okviru OPS-a, delegirane od strane supervizora ili više hijerarhije ili sa obavezama koje proizilaze iz okvira odgovornosti u OPS-u i CBK-u.

Stručna sprema/kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma iz oblasti IT nauka, inženjerstva i ekonomije (smerovi: menadžment i informatika ili bankarstvo i finansije);
- Najmanje dve (2) godine iskustva sa računarskim aplikacijama/sistemima, direktno povezanim sa infrastrukturom za međubankarske platne usluge ili druge finansijske usluge, poželjno iskustvo u bankarskom sektoru;
- Kandidati sa iskustvom i znanjem u administriranju i tehničkoj podršci međubankarskih platnih sistema, kao i finansijskih poruka koje se koriste u ovim sistemima, imaće prednost;
- Organizacione i veštine planiranja i upravljanja vremenom;
- Međuljudske i komunikacijske veštine, kao i sposobnost rešavanja problema i brzog prilagođavanja novim dešavanjima;
- Tačnost, pažnja prema detaljima i osetljivost na prioritete;
- Napredno poznavanje korišćenja MS Office softverskih aplikacija;
- Treba da ima tečno poznavanje albanskog i/ili srpskog jezika u govoru i pisanju;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno (motivaciono) pismo gde se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje funkcije koju je vršio/la i radno iskustvo, ne dovodeći u pitanje relevantne akte za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj Fonda penzione štednje Kosova (Trust)** za relevantni period, ili poresku potvrdu Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta zakonski ne primenjuje;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate /nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koji služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Procedura apliciranja:

- Roka za apliciranje je **09. oktobar 2025. godine**

- Apliciranje se može obaviti na mreži (<https://hris.bqk-kos.org>) preko službene internet stranice të CBK-a. Drugi oblici apliciranja neće se uzeti u obzir.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Pasqyra” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810873738 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "Pasqyra" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810873738 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Pasqyra” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810873738 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- B.I. "ILLCOM" nga Gjakova, shpall të pavlefshme numrin UNIK identifikues: 811412981 të lëshuar nga ARBK.

- Drlon Xëerxa nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10,11,12,13 të shkollës së mesme profesionale "Gjon N. Kazazi", Gjakovë.

- Granit Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme Sh.M.Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- NNSH "Meridian", shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishtme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.


- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L